



Promovim i zanateve 2019 në Pratteln – prezantimi në gjuhën tuaj

Të dashur prindër, të dashur të interesuarë

Keni fëmijë, të cilët janë para përzgjedhjes së zanatit ose që dëshirojnë të mësojnë një zanat? Atëherë patjetër të vizitoni **Promovimin e zanateve në Pratteln. Prej datës 23 deri më 27 tetor** ju tregojmë se si funksionon sistemi profesional arsimor në Zvicër.

Ne ju informojmë për mundësit e ndryshme për mësimin e zanateve që i keni Ju ose fëmija i Juaj. Merrni edhe bijat dhe djemtë tuaj me vete në promovimin e zanateve, në mënyrë që ata të mund të përjetojnë vetë shumë zanate. Në këtë ditë mund të merrni nga profesionistët e pranishëm direkt përgjigje për pyetjet si "Si dhe ku mund të gjej një vend për të mësuar zanatin?", "Si mund ta vazhdoj shkollimin pas diplomimit?", "Çfarë lloj shkollave profesionale mund të ndjek?" ose " Çfarë page mund të marr?"

Më 26 tetor mbahet prezantimi i zanateve në gjuhën tuaj. Detajet më të sakta mund t'i gjeni në linkun www.berufsschau.ch/fuer-eltern, **ku edhe mund të lajmëroheni direkt për pjesëmarrje.** Ju presim përzemërsisht dhe gëzohemi për vizitën tuaj!

Prezantimi në gjuhën shqipe: E shtunë, 26.10.2019, në orën 14:00